

RAPORT MONITORIMI Nr. 6

mbi kufizimet e
përdorimit
të burimeve
shtetërore në
fushatën
zgjedhore

Periudha
25 mars - 25 prill 2021

Me bashkëpunimin e ped-
agogëve dhe studentëve
monitorues pranë universi-
teteve në shtatë rajone të
vendit

Projekti

*“Forcimi i Transparencës
së Zgjedhjeve në Shqipëri”*



Ky projekt mbështetet nga ambasada e Mbretërisë së Holandës në Tiranë dhe programi i përbashkët i Këshillit të Evropës dhe Bashkimit Evropian “Aksioni kundër Krimit Ekonomik në Shqipëri”



Kingdom of the Netherlands

Funded
by the European Union
and the Council of Europe



Implemented
by the Council of Europe

Ky raport pasqyron gjetjet e monitorimit të zbatimit të dispozitave të reja të Kodit Zgjedhor, në drejtim të:

- sjelljes së administratës shtetërore gjatë fushatës zgjedhore;
- përdorimit të aseteve publike për qëllime elektorale;
- shpenzimeve dhe materialeve propagandistike të subjekteve zgjedhore.

Projekti SETA monitoroi zbatimin e këtyre kufizimeve në shtatë qarqe kryesore të vendit (Shkodër, Durrës, Tiranë, Elbasan, Vlorë, Gjirokastrë dhe Korçë) falë bashkëpunimit të 54 pedagogëve dhe studentëve duke përdorur metodologjinë e monitorimit të hartuar nga ekspertiza ndërkombëtare e siguruar nga bashkëpunimi me programin e **përbashkëttë** Këshillit të Evropës dhe Bashkimit Evropian “Aksioni kundër **Krimit Ekonomik në Shqipëri**” dhe aprovuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Njëkohësisht, bashkëpunimi me gazetarët vendorë të trajnuar nga projekti dhe mentoruar nën metodologjinë e verifikimit të fakteve (fact-checking) nga organizata mediatike “Faktoje”, zgjeruan më tej rrjetin e monitorimit të përdorimit të burimeve shtetërore dhe kufizimeve të tjera gjatë fushatës zgjedhore.

Falë nënshkrimit të një Marrëveshje Bashkëpunimi me Departamentin e Administratës Publike, u mundësua shkëmbimi efikas dhe i shpejtë i informacionit të kërkuar mbi emërimet dhe lëvizjet e nëpunësve të shërbimit civil në institucionet e administratës shtetërore pjesë e shërbimit civil.

Disa nga gjetjet kryesore të monitorimit janë:

- Kufizimet e Kodit Zgjedhor për emërimet dhe largimet në administratën shtetërore nuk kanë rezultuar efektive duke u fokusuar vetëm në periudhën një mujore të fushatës.
- Asetet publike, kryesisht shkollat e sistemit parauniversitar, janë vendosur në dispozicion të aktiviteteve elektorale të mazhorancës. Deri më sot nuk janë konstatuar presione ndaj nxënësve për të marrë pjesë në këto aktivitete.

- Pavarësisht kufizimeve në përdorimin e burimeve institucionale gjatë fushatës, ministrat dhe zyrtarët e lartë kandidatë nuk kanë bërë një ndarje të qartë mes funksionit të detyrës së tyre dhe aktivitetit si kandidatë politik.
- Materialet propagandistike elektorale kanë qenë kryesisht të kufizuara dhe të afishuara në ambiente promovimi.
- Dhuratat e ofruara nga kandidatët nuk i janë përmbajtur në të gjitha rastet kufirit të kostos prej 500 lekë. Konstatohen gjithashtu raste të organizimit të eventeve kulturore dhe sportive me pjesëmarrjen e kandidatëve.

Administrata publike gjatë fushatës

Me nisjen zyrtare të fushatës zgjedhore (26 mars), hynë në fuqi kufizime të mëtejshme të Kodit Zgjedhor për përdorimin e burimeve publike dhe sjelljen e administratës shtetërore. Më konkretisht, kufizimet përcaktuan si më poshtë vijon:

Kufizimet për administratën shtetërore

- *Përdorimi i detyruar në fushatën zgjedhore i administratës së institucionit brenda orarit të punës për qëllime zgjedhore. [Neni 91, pika 2]*
- *Premtimi ose ofrimi i përfitimeve ndaj nëpunësve publike, ose studentëve për të marrë pjesë në*

aktivitete që lidhen me fushatën jashtë orarit të punës ose shkollës ose të ushtruarit e presionit mbi to për këtë qëllim. [Neni 91, pika 2]

- *Punësimi, pushimi nga puna, lëvizja dhe transferimi në detyrë në institucione ose ente publike gjatë fushatës zgjedhore, përveç rasteve të justifikuara. [Neni 91, pika 3]*

Bazuar mbi kufizimet e Kodit Zgjedhor, më 8 mars 2021, **Departamenti i Administratës Publike (DAP)** hartoi një dokument të brendshëm/Memo për të qartësuar më tej ndalime/kufizime/detyrime për nëpunësit/punonjësit civilëtë institucioneve të administratës shtetërore gjatë fushatës zgjedhore. Dokumenti nënvizoi më tej detyrimet e nëpunësve civilë pjesë e këtyreinstitucioneve për:

- Nëpunësit civilë që kandidojnë në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, detyrohen të kërkojnë pezullimin nga detyra.
- Nëpunësve civilë të administratës shtetërore, gjatë orarit zyrtar të punës dhe brenda mjediseve të institucioneve shtetërore, u ndalohet çdo lloj pjesëmarrjeje në veprimtari me karakter politik apo në funksion të politikës partiake/kandidatëve apo në fushatë zgjedhore të një subjekti zgjedhor ose kandidati në zgjedhje.
- Nëpunësit civilë nuk mund të shprehin publikisht bindjet apo preferencat e tyre politike gjatë ushtrimit të detyrës apo gjatë pjesëmarrjes në veprimtari politike apo zgjedhore dhe nuk mund të bëjnë fushatë për një subjekt zgjedhor apo kandidat.
- Gjatë fushatës zgjedhore ndalohet marrja në punë, pushimi nga puna, lirimi, lëvizja dhe transferimi në detyrë në institucionet apo entet publike, me përjashtim të rasteve kur; (i) lëvizja apo lirimi nga puna vjen si rrjedhojë e shkeljeve, sipas legjislacionit përkatës; (ii) marrja në punë bëhet bren-

da strukturës dhe organikës në fuqi përpara fushatës zgjedhore. Bëjnë përjashtim rastet e emergjencave për shkak të ngjarjeve të paparashikuara që diktojnë marrjen në punë.

- Gjatë fushatës zgjedhore ndalohen shtesat në organikën e çdo institucioni publik apo entet publike apo emërimet provizore në to.

Gjithashtu, **Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil (KMSHC)**, në shkresën nr. 458, datë 05.04.2021, drejtuar grupeve të monitorimit të burimeve njerëzore të institucioneve pjesë e shërbimit civil, interpretoi më tej këto kufizime duke e shtrirë fushën e tyre të veprimit edhe në mediat sociale. Sipas përcaktimit të Komisionerit: “... *ndarja apo pëlqimi i materialeve elektorale të subjekteve politike në mediat sociale (Facebook, Twitter, Instagram) në llogaritë personale të punonjësve civilë përbën shkelje të detyrimit për të mos shprehur publikisht bindjet apo preferencat e tyre politike*”. Ky është një interpretim për t’u përshëndetur dhe në linjë me rekomandimin e raporteve të mëparshme SETA ndaj KQZ dhe institucioneve të tjera publike monitoruese gjatë fushatës për ta cilësuar median sociale në të njëjtën nivel si median tradicionale, për shkak se ka në bosht të saj ndarjen dhe shpërhapjen e informacionit, ideve, pikëpamjeve dhe bindjeve.

Institucioni i Komisionerit pritet të publikojë në raportin e ardhshëm të dhënat mëtejshme mbi rezultatet e grupeve të monitorimit të ngritura pranë institucioneve publike për të verifikuar zbatimin e këtyre kufizimeve dhe sjelljes e nëpunësve gjatë fushatës.

Për të monitoruar zbatimin e kufizimit për emërimet apo ndryshimet në organikën e administratës shtetërore, projekti SETA u mbështet mbi të dhënat zyrtare të Departamentit të Administratës Publike. Duhet qartësuar se DAP, është organi përgjegjës për administrimin e shërbimit civil

në administratën e Këshillit të Ministrave, ministritë, institucionet qendrore në varësi të Kryeministrit apo ministrave, përfshirë degët e tyre territoriale, si dhe administratën e prefektit. Pjesa tjetër e punonjësve publikë, e cila përbën edhe peshën kryesore të punonjësve të paguar nga fondet publike, si përshebull, punonjësit e policisë së shtetit, forcat e armatosura, etj, funksionojnë me ligjet e tyre të posaçme dhe nuk kanë një administrim nga DAP. **Për këtë arsye, të dhënat e prezantuara më poshtë me burim DAP, janë të reduktuara vetëm për trupën e shërbimit civil, pjesë e administratës shtetërore**

Më konkretisht, rezulton se gjatë fushatës zgjedhore (26 mars-23 prill 2021) u kryen:

- 63 emërimet e reja në shërbimin civil, të zhvilluara si vijim i procedurave të publikuara në muajin janar dhe shkurt 2021, procedura të shpalluar në zbatim të [VKM nr.13](#), miratuar më 27.01.2021 për Planin vjetor të pranimit për vitin 2021 në institucionet e administratës shtetërore, pjesë të shërbimit civil, e cila përcakton se numri i vendeve vakante të planifikuarapër rekrutim gjatë vitit 2021 është gjithsej, 705 (shtatëqind e pesë).
- 28 lirime nga Shërbimi Civil (6 Pension pleqerie, 16 dorëhequr, 2 nëpunës të dënuar me vendim të formës së prerë, 2 nëpunës të ndarë nga jeta, 2 nëpunës të larguar me masë disiplinore);
- Nuk janë bërë transferime të përhershme dhe ose të përkohshme për shkaqe ligjore të parashikuara në ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar. *(Pranë KQZ është denoncuar më 12 prill drejtoresha e AZHBR, Frida Krifca për një transferim të denoncuesit gjatë fushatës zgjedhore nga Agropika Gjirrokastër në Agropikën Kukës. Hetimi administrativ ka rezultuar pa shkelje bazuar në vendimin e KQZ nr. 334, datë 05.05.2021)*

Të dhënat zyrtare konfirmojnë se ka patur emërimet dhe lëvizjet edhe gjatë fushatës, edhe pse në shifra minimale. Këto ndryshime janë

argumentuar si vijim i procedura të nisura përpara 26 marsit, në zbatim të legjislacionit në fuqi për shërbimin civil (VKM nr. 13 datë 27.01.2021 për Planin vjetor të pranimit për vitin 2021 në institucionet e administratës shtetërore, pjesë të shërbimit civil), para nisjes së fushatës, kur hyjnë në fuqi edhe kufizimet e Kodit Zgjedhor. **Si rrjedhojë, kufizimi i parashikuar në Kod mund të thuhet se ka qenë jo efektiv në arritjen e objektivit për të ndaluar lëvizjet në administratë që mund të sjellin përfitime elektorale.**

Për të kuptuar nëse ka patur fryrje të strukturave të shërbimit civil të lidhura me zgjedhjet, DAP na vendosi në dispozicion strukturën e administratës së ministrive në fundin e vitit 2019 dhe 2020, ku rezulton një rritje prej 189 punonjësish, e argumentuar me situatën e Covid-19 dhe me ristrukturimin e institucioneve.

Denoncimet e opozitës për një rritje me rreth 10 mijë punonjësish të strukturës së administratës publike në fund të vitit 2020, iu referuan statistikave të INSTAT, më konkretisht [Të Dhënat Administrative të Tregut të Punës](#), të cilat paraqitën një shifër të përgjithshme, përkatësisht 182.547 personash të paguar nga buxheti i shtetit në fund të vitit të kaluar. Kjo rritje është justifikuar me nevojat e lindura pas tërmetit dhe pandemisë së Covid-19, **Në tremujorin e parë të vitit 2021, kjo shifër rezulton të jetë rritur edhe më tej me 1.382 të punësuar.** DAP vendos disa pikëpyetje mbi saktësinë dhe metodologjinë përdorur nga INSTAT për të arritur në këtë shifër. Megjithatë, duhet nënvizuar se sistemi aktual i kontrollit dhe administrimit të strukturës së punonjësve publikë, ku DAP nëpërmjet portalit elektronik HRMIS mund të menaxhojë më pak se 15 % të të gjithë punonjësve shtetërorë, e bën të vështirë edhe për këtë institucion verifikimin e të dhënave për të gjithë trupën.

Një tjetër fenomen që ngjalli akuza gjatë fushatës zgjedhore ishte numri në rritje i **punonjësve me kontratë apo të cilësuar si staf i përkohshëm.** Projekti SETA verifikoi statistikën për punonjësit me kontratë, një kategori punonjësish që nuk ka statusin e shërbimit

| Shërbimi civil në institucione | Dhjetor 2019 | Dhjetor 2020 | Diferenca |
|--|---------------|---------------|------------|
| Sistemi në varësinë e Kryeministrit | 3378 | 3427 | 49 |
| Sistemi i ministrisë së Sportit dhe Rinisë | 814 | 829 | 15 |
| Sistemi i ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural | 1929 | 1967 | 38 |
| Sistemi i ministrisë së Drejtësisë | 5282 | 5282 | 0 |
| Sistemi i ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë | 1303 | 1332 | 29 |
| Sistemi i ministrisë së Financës dhe Ekonomisë | 4395 | 4359 | -36 |
| Sistemi i ministrisë së Kulturës | 1012 | 1011 | -1 |
| Sistemi i ministrisë së Mbrojtjes | 563 | 656 | 93 |
| Sistemi i ministrisë së Turizmit | 1088 | 866 | -222 |
| Sistemi i ministrisë së Brendshme | 1129 | 1348 | 219 |
| Sistemi i ministrisë së Evropës dhe Punëve të Jashtme | 204 | 209 | 5 |
| Sistemi i ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale | 3449 | 3449 | 0 |
| Total | 24,546 | 24,735 | 189 |

Burimi DAP

civil, por rekrutohet në varësi të nevojave për të kryer detyra të përkohshme apo krijimit të vakancave në institucione (leje shëndetësore, lindjeje etj) dhe përfshin kryesisht punonjës mbështetës (pastrues, punonjës komunikimi, mirëmbajtje etj).

Sipas të dhënave të DAP, për vitin aktual janë miratuar 2.472 punonjës me kontratë, bazuar në VKM nr. 1151, datë 24/12/2020. Ky vendim është miratuar dy ditë para hyrjes në fuqi të Vendimit nr.9 të KQZ dhe nisjes së kufizimeve të periudhës 4-mujore zgjedhore.

Për të analizuar këtë të dhënë, është e nevojshme që të kryhet një krahasim me vitet e kaluara. Rezulton se kontratat e përkohshme të këtij viti janë më të larta se viti 2019, një vit po ashtu elektoral, por më të ulta se ai 2020, kur rritja është argumentuar me situatën e Covid-19 dhe kërkesën për punonjës shtesë për sektorët e arsimit, shëndetësisë dhe OS-HEE.

Shtesat në punonjës janë ndarë sipas institucioneve:

| Institucioni | Punonjës me kontratë |
|-----------------------------|----------------------|
| Kryeministria | 85 |
| Ministria e Bujqësisë | 248 |
| Ministria e Infrastrukturës | 76 |
| Ministria e Financave | 662 |
| Ministria e Arsimit | 75 |
| Ministria e Kulturës | 72 |
| Ministria e Shëndetësisë | 844 |
| Ministria e Jashtme | 23 |
| Ministria e Brendshme | 66 |
| Ministria e Turizmit | 55 |
| Të tjera | 266 |
| Total | 2,472 |

Burimi: VKM nr. 1151, datë 24/12/2020

Më konkretisht:

- Në vitin 2019 u miratua numri tavan i 1.806 punonjës me kontratë;
- Në vitin 2020 ky numër arriti në 2.628 punonjës. Rritja prej 1.201 punonjësish është krijuar nga shtimi i:
 - 745 punonjësish për Operatorin e Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor dhe Qendrën Kombëtare të Urgjencës Mjekësore;
 - 65 për disa institucione të pavarura (SPAK, ILD, KQZ);
 - 25 për Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile;
 - 300 për Autoriterin Kombëtar të Veterinarisë për shkak të funksionit të veterinerëve zyrtarë të shtuar për këtë institucion;
 - 66 janë shtuar në institucione të ndryshme për shkak të nevojave të tyre.

Në lidhje me **kufizimin e nëpunësve që kandidojnë**, të dhënat e raportuara nga DAP, bazuar në informacionin e përcjellë nga njësitë e burimeve njerëzore mbi aparatet e ministrive të linjës dhe institucioneve e varësisë, konfirmojnë 9 nëpunës civilë të pezulluar nga detyra për shkak të kandidimit në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë. Kjo e dhënë është e vështirë që të konfirmohet për shkak se formulari i deklarimit të kandidatëve pranë KQZ nuk përmban të dhëna për punësimin, çka do të mundësonte të dhëna të sakta për kandidatët me status “nëpunës civil”. Në këtë situatë, zbatimi i këtij kufizimi është i vështirë që të kontrollohet edhe nga vetë KQZ dhe subjekte të tjera monitoruese. Do të ishte me vlerë që në zgjedhjet e ardhshme të detajohej më tej informacioni që ofrojnë kandidatët në procesin e regjistrimit pranë KQZ.

Përsa i përket kufizimit të parashikuar në Nenin 91, pika 2 të Kodit Zgjedhor mbi për-

dorimin e detyruar në fushatën zgjedhore të **administratës** së institucionit brenda orarit të punës, denoncimet pranë portaleve të KQZ kanë qenë të pakta në numër (2 denoncime nga PD). Sigurisht, rasti më i njohur ishte ai bisedës telefonike të publikuar nga ERTVku Kryeministri, z. Edi Rama dhe ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural znj. Mil-va Ekonomi, u akuzuan se ushtruan presion ndaj punonjësve të arsimit dhe shëndetësisë për të votuar për mazhorancën. Ky denoncim u shqyrtua nga KQZ dhe në vendimin e saj Vendimi nr. 248, datë 16.04.2021, u cilësua si “një keqintepretim dhe diskutim i nxjerrë nga konteksti”.

Një artikull investigues i mbështetur nga projekti SETA në bashkëpunim me organizatën mediatike “Faktoje”, dëshmoi implikimin gjatë orarit zyrtar të punës të punonjësve të Bashkisë Korçë në promovimin e fiushatës të ministrit të Mbrojtjes, z. Niko Peleshi si dhe anëtarëve të kabinetit të ministres për Evropën dhe Punët e Jashtme, znj. Olta Xhaçka, të dy kandidatë në zonën e Korçës. Ky sigurisht nuk është një fenomen i kufizuar vetëm në këtë zonë, por shpesh i vështirë për t’u provuar.

Monitorimi i përdorimit të aseteve publike

Kufizimet për përdorimin e aseteve publike

- *Ndalimi i fushatës zgjedhore në një institucion publik [Neni 78, pika 6]*
- *Vënia në dispozicion të subjekteve zgjedhore të burimeve të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor apo çdo lloj enti tjetër ku shteti zotëron kapitale. [Neni 91, pika 1]*
- *Përdorimi i detyruar dhe i organizuar brenda orarit të mësimit i studentëve të sistemit shkollor para-universitar në fushatën zgjedhore. [Neni 91, pika 2]*

Monitorimi në terren si dhe denoncimet e mbërritura pranë KQZ dëshmojnë për një përdorim të ambjenteve të shkollave publike për të organizuar takime elektorale. Këto takime janë zhvilluar kryesisht nga kandidatët e mazhorancës duke argumentuar nevojën për të siguruar masat anti-covid (pra qëndrimin në ambjent të hapur) si dhe faktin që takimet janë zhvilluar jashtë orarit mësimor, pa prezencën e nxënësve (pasditeve apo në fundjava) dhe në shkollat që janë qendra komunitare. Monitorimi ynë si dhe një [artikull investigues](#) i mbështetur nga projekti SETA ka konstatuar mbi 20 raste të publikuara të takimeve të kandidatëve të Partisë Socialiste në oborret e shkollave, kryesisht në Tiranë, Durrës, Krujë, Gjirokastrë. Nuk janë konstatuar ndërkohë takime të ngjashme të kandidatëve të opozitës në shkolla në këto qytete, duke u krijuar edhe atyre shanse të barabarta gjatë fushatës.



Kryetari i Bashkisë Krujë, Artur Bushi më 9 prill brenda shkollës “Bakushe Visha”, duke folur përkrah kandidatëve socialistë Milva Ekonomi, Rrahman Rrahja dhe Denis Deliu.



Më datë 4 prill (e dielë), kandidatët e PS në palëstrën e shkollës “Bakushe Visha” ku u organizua një ndeshje voleybolli me të rinjtë e forumit rinor socialist të zones.



Kandidati Bledi Çuçi, takim më 15 prill në oborrin e përbashkët të gjimnazit “Siri Shap- llo” dhe Kishës së Shën Mihalit, Gjirokastrër.



“Screenshot” nga video në faqen e Erion Veliajt, mbi prezantimin e kandidatit Fidel Ylli, në obor- rin e gjimnazit “Vajdin Lamaj”, Vorë

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka shqyrtuar deri më tani dy denoncime për takime në ambjentet e shkollave të deputetëve Elona Gjebrea dhe Ervin Bushati ([Vendimi nr. 101](#) & [102](#), datë 25.02.2021), të cilët nuk u cilësuan si aktivitete të ndaluara. Megjithatë, KQZ ofroi një saktësim të mëtejshëm për këtë çështje me rekomandim ndaj drejtuesve të shkollave për të evituar prezencën e deputetëve në aktiviteve të shkollës.

Nuk janë konstatuar raste të **presionit ndaj nxënësve** të sistemit parauniversitar për të marrë pjesë në aktiviteteve elektorale, kjo ndoshta edhe për shkak të takimeve jo masive nën situatën e Covid-19 dhe zhvillimit të mësimin online.

Përsa i përket përdorimit të **burimeve të tjera institucionale në funksion të fushatës**, është e vështirë që të provohet masa e përdorimit të zyrave, pajisjeve kompjuterike, telefonave apo shumë burimeve të tjera kur kandidatët janë njëkohësisht edhe zyrtarë të lartë. Megjithatë, një qasje praktike për të kuptuar deri ku mund të shkojë përdorimi i burimeve institucionale, është përdorimi i automjeteve të zyrës nga anëtarët e qeverisë në aktivitetet e tyre të fushatës. Kryeministri Edi Rama, që prej ditës së parë të fushatës ka nisur të udhëtojë në të gjithë takimet jashtë Tiranës me një mjet të tipit “Linkoln Navigator”, i cili është përdorur edhe në fushatat e mëparshme kur ishte lideri i opozitës dhe është deklaruar si mjet personal i kryeministrit.



Foto: Në sfond mjete personal i përdorur nga kryeministri Rama gjatë fushatës zgjedhore

Megjithatë, në të gjitha takimet elektorale të fushatës kryeministri ka qënë përsëri i shoqëruar nga dhjetëra forca të dukshme të Gardës së Republikës dhe policisë si dhe mjeteve të regjisë së Televizionit Publik Shqiptar të mbështetura edhe me gjeneneratorë për të siguruar transmetimin live në kanalën ERTV të aktiviteteve të tij si kandidat i forcës politike PS.

I njëjti konstatim është edhe për ministrat e kabinetit kandidatë, të cilët kanë udhëtuar gjatë fushatës herë me mjetet e institucionit dhe herë me mjete të tjera të huazuara, por duke qënë përsëri në shoqërinë e shoferëve dhe shoqëruesve të Gardës në zonat e tyre elektorale. Monitorimi SETA është ende në pritje të përgjigjeve zyrtare nga ministrat për të konfirmuar nëse drejtuesit e tyre kanë udhëtuar me kostot personale apo në funksion të detyrës. Përgjigjet do të bëhen publike në raportin e ardhshëm.

Monitorimi i shpenzimeve gjatë fushatës

Kufizimet për shpenzimet dhe materialet propagandistike

- *Subjekti zgjedhor/Kandidati i ndalohet të organizojë ose mbulojë shpenzimet për koncerte, evente kulturore dhe argëtuese ose aktivitete bamirësie. [Neni 78, pika 9]*
- *Subjekti zgjedhor/Kandidati të ofrojë artikuj ose materiale të printuara me vlerë prej më shumë se 5(pesë) qind Lekë për artikuj ose materiale zgjedhore. [Neni 78, pika 10]*
- *Paraqitja e materialeve propagandistike statike më shumë se 5 metra nga zyrat zgjedhore. [Neni 79, para 2]*
- *Zyra zgjedhore të hapura në një distancë më të vogël se 300 metra nga vendndodhja e KZAZ-ve, QV-ve dhe VNV-ve. **Udhëzimi nr.6 datë 23.03.2021 i KQZ-së***
- *Mospërfshirja e deklaratës së autorizimit në materialet vizive të fushatës propagandistike [Neni 79, para 3]*

Vlen të theksohet se kryesisht partitë politike dhe kandidatët i zbatuan kufizimet për të evituar materialet propagandistike masive dhe shpenzime të shtrenjta për evente fizike. Kjo jo vetëm në vijim të eksperiencës së dy zgjedhjeve të fundit, por edhe për shkak të pandemisë që nuk lejonte mitingje ku ka nevojë të dëshmohet mbështetja e pjesëmarrësve. Megjithatë, rastet e shkeljeve të konstatuara nuk munguan edhe në këtë drejtim.

Edhe pse jo në formatin klasik me prezencën e këngëtarëve apo artistëve, **evente kulturore** për të organizuar të rinjtë mbështetës rezultojnë se u zhvilluan me prezencën e disa prej kandidatëve në Shkodër, Kamëz dhe Gjirokastrë. Në këto evente argëtuese apo sportive pjesëmarrja ka qënë falas dhe të gjitha shpenzimet janë mbuluar nga organizatorët.



Shfaqje e filmave (aktivitet 3 ditor) në Shirokë, Shkodër dhe festë me të rinjtë e FRESSH me pjesëmarrjen e kandidatës së PS, Lela Bërdica.



Aktiviteti argëtues me të rinjtë zhvilluar më 12 prill në kalanë e Gjirokastrës, si dhe koncerti i mbajtur më 13 prill në rrethinat e qytetit, me prezencën e kandidatës së PS, Artemis Malo



Kandidatët e PD Flamur Noka dhe Korab Lita morrën pjesë në eventin sportiv të organizuar më 10 prill pranë kompleksit privat "S.." në Kamëz, ku u zhvilluan ndeshje futboll-basketboll me të rinjtë.

E njëjta situatë është konstatuar edhe për kufizimin e **dhuratave deri në 500 lekë** që mund të ofrohen nga kandidatët. Maska, bluza t-shirt dhe bluza tutash (hoodie) ishin dhuratat më të zakonshme për mbështetësit dhe pjesëmarrësit në eventet e kandidatëve. Disa prej cmimeve të artikujve të siguruara nga një prej kompanive kryesore të promocioneve në këtë fushë, konfirmonin se kufiri prej 500 lekësh është i ulët për të përballuar koston e tutave apo bluzave t-shirt të stampuara.

Listë çmimesh mesatare për materiale promocioni (deri 100 copë - TVSH përfshirë)

- Bluzë t-shirt e stampuar – 900 / 1.000 lekë
- Xhup i hollë për shiun – 1.400 lekë
- Bluze tutash/hoodie – 2.400 lekë



Kandidati i PS Ervin Bushati duke promovuar bluzat T-shirt të printuara dhe i veshur vetë me bluzën e tutave me logo.



Kandidatja e PD Jorida Tabaku, duke promovuar bluzat e tutave të printuara me logon dhe emrin e saj.

Një nga dhuratat më të zakonshme dhe e shpërndarë në mënyrë masive ishte veshja mushama kundër shiut. Përkundër zhvillimit të një fushate pa grumbullime masive, në 3-4 ditët e fundit të saj, PS organizoi mitingjeve përmbyllëse me pjesëmarrje të gjerë në qytetet kryesore të vendit. Në dy prej tyre, në Elbasan dhe Tiranë, më konkretisht në datat 21 dhe 22 prill, për shkak të motit me shi, pjesëmarrësve iu shpërndanë mushama njëpërdorimëshe dhe flamurë kombëtarë të vegjël. Monitoruesit



SETA arritën të sigurojnë njëren prej mushamave të ndara në mitingun e Elbasanit, e cila rezultoi të importuar nga Italia. Në shitje me pakicë, një produkt i tillë arrin vlerën e 1.2 - 1.5 euro (rreth 150 lekë) ndërkohë që flamujtë në shitjen me pakicë kanë një kosto nën 50 lekë për copë. Sigurisht blerja në sasi të mëdha, ashtu sic rezultoi nga numri i pjesëmarrësve në të dy mitingjet ul ndjeshëm cmimin për copë të këtyre produkteve. Bazuar mbi këto përlogaritje konstatohet se nuk është kaluar pragu i përcaktuar nga Kodi Zgjedhor.



Fotot lart: Kandidati i PS Taulant Balla duke ndihmuar në veshjen e mushamasë një nga pjesëmarrëset në mitingun përmbyllës në Elbasan më 21 prill (foto djathtas)

Foto poshtë: Mushamatë e përdorura në mitingun përmbyllës të PS në Tiranë si dhe ato në mitingun e LSI në Tiranë, të përdorura në një sasi të kufizuar.

Në lidhje me kufizimet e vendosjes së **materialeve propagandistike statike** në fasadat e godinave të banimit, institucione publike ose ambiente rrethuese pranë e rreth tyre, janë konstatuar prezencë e posterave (billboard) e afishuar në fasada apo instalime promocionesh private nga kandidatët e forcave kryesore në Tiranë, Shkodër, Elbasan dhe sidomos në Gjirokastrë. Në vendimmarrjen e KQZ në [Vendimin nr. 203 / 07.04.2021](#) (Material i PS në ekranin promocional LED në Komunën e Parisit) u argumentua se rasti i materialeve propaganduese në hapësira të kompanive private të promovimit nuk mund të konsiderohet si shkelje përderisa këto hapësira janë të licensuara nga organet e qeverisjes vendore. Sidoqoftë, shembujt e hasura gjatë fushatës janë të ndryshme dhe mbetet për t'u shqyrtuar rast pas rasti nëse ka apo jo shkelje të kufizimit për promovimet elektorale në fasada publike.



Posteri (billboard) i kandidatit të PD Bardh Spahija në Shkodër dhe ai i kandidatit të PS, Bledi Çuçi në hyrje të Gjirokastrës.

Foto poshtë: Postera të kryeministrit Edi Rama dhe kandidatit të PD, Lefter Gështenja në rrugën nacionale në hyrje të Librazhdit

Rastet e ngjitjes së posterave propagandistike në ambiente publike ishte një fenomen i kufizuar (kandidatët e PS Halit Valteri në Kamëz dhe Rrahman Rraja në Krujë) dhe që nuk u konstatua në një përhapje të madhe. Kandidatë të tjerë zgjodhën të bënin promovim të fushatës së tyre në formate më krijuese duke iu shmangur përcaktimit të formatit “material statik” të parashikuar në Kodin Zgjedhor.



Fotot: Projektimi mbi fasadën e UPT të logos dhe numrit të PD si dhe materiale propagandistike jostatike të kandidatit të PD Agron Shehaj, Pandeli Majko dhe Mimi Kodheli

Në lidhje me kufizimet e **distancave të vendosjes së materialeve propagandistike** nga qendrat e votimit, monitoruesit SETA konstatuan shkeljen e largësisë prej 300 metrash të një posteri të kandidatit Bledi Çuçi, të vendosur pranë KZAZ në në bulevardin “18 Shtatori” Gjirokastrë. Gjithashtu, një shkelje e mbështetur edhe nga vendimmarrja e KQZ ([Vendimi nr. 235](#) datë 14.04.2021) u konstatua në fasadën e bashkisë Librazhd, ku ekspozohej një poster i PS në një institucion publik. Për këtë rast, KQZ vendosi vetëm këshillin e kryetarit të bashkisë Kastriot Gurra dhe urdhërimin e policisë bashkiake për heqjen e menjëhershme të materialit.



Fotot: Billboard i kandidatit Bledi Çuçi i vendosur rreth 30 metra nga KZAZ Gjirokastrë, i pazhvendosur deri më 26 prill. Foto tjetër, posteri i PS në fasadën ballorë të bashkisë Librazhd

Përsa i përket detyrimit të **deklaratës së autorizimit** në materialet vizive të fushatës zgjedhore, ky përcaktim nuk u respektua gjerësisht në materialet e promovimit të kandidatëve dhe subjekteve. Forcat politike kryesore u mjaftuan me vendosjen e logos së tyre në pjesën anësore të materialeve vizive duke shkelur detyrimit e Kodit Zgjedhor për të vendosur shënimin: *“Prodhuar nën përgjegjësinë ligjore të...”* Deri më sot nuk janë publikuar masa ndëshkuese nga AMA (autoriteti i mandatuar për monitorimin e medias gjatë fushatës) ndaj transmetuesve televizive si dhe një vendimmarrje e KQZ ndaj subjekteve elektorale për shkelje të konstatuara për këtë përcaktim ligjor.

Rekomandime

- Struktura aktuale e menaxhimit të administratës shtetërore, përtej shërbimit civil, e bën të pamundur kontrollin e plotë të emërimeve dhe ndryshimeve që mund të ndodhin në prag të zgjedhjeve. Kufizimet aktuale në Kodin Zgjedhor, të cilat janë fokusuar në periudhën e fushatës zgjedhore (vetëm 1 muaj) rezultojnë të pavlefshme në rast se strukturimet e organike me efekt zgjedhor nisin disa muaj përpara.

- Pavarësisht ndryshimeve pozitive në legjislacionin për financimet e fushatave, kontrolli i përdorimit të burimeve shtetërore në zgjedhje kërkon shumë më tepër hetim dhe auditime pranë institucioneve përkatëse. Mund të jetë më vlerë që Kontrolli i Lartë i Shtetit, si institucioni kryesor auditues, të plotësojë më tej detyrat e ngarkuara ndaj KQZ nga Kodi Zgjedhor.

- Kufizimet për përdorimin e burimeve institucionale nga ministrat dhe zyrtarët që kandidojnë duhet që të shoqërohen me akte dytësore dhe rregullore të brendshme institucionale për të përcaktuar më mirë ndarjen mes detyrës dhe angazhimit politik si dhe transparencën e duhur ndaj publikut.